



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**
P-nr.38/2022
Prishtinë, më 16.5.2022, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Albana Bytyçi, Alban Bajrami, Labinotë Murtezi, Drita Millaku, Ariana Musliu –Shoshi, Eliza Hoxha dhe Milosh Peroviq.

Munguan: Tinka Kurti, Vafije Krasniqi dhe Marigona Geci.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sultane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Albulena Uka-Ministria e Drejtësisë, Lindita Rexha-LVV, Festim Bytyçi - AAK, Gentiana Ahmeti-Kallxo.com, Doresa Deliu-KDI, Teuta Prekazi Haxhi Beqiri-UN, Adnan Selmani-SH.C, Durim Elshani-LV, Hilmi Jashari-ekspert i pavarur, Nita Shala-Ministria e Drejtësisë, Edi Gusia-ABGJ-ZKM, Leonora Selmani-ABGJ-ZKM, Fjolla Muqaj-IPS “Misine Kokollari”, Artë Ademi Bajrami-Ministria e Drejtësisë, Vlora Nushi-UN Women, Nazlie Bala-Ministria e Drejtësisë, Celal Ilyas, Kuvendi i Kosovës dhe Fikreta Radonçiq-Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen fillimisht e kryesoi Duda Balje, kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Takim në komision me ekspertin e angazhuar nga UN Women, lidhur me përfundimin e draft ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore.
Të ftuar edhe përfaqësuesit nga: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Barazi Gjinore dhe UN Women;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më parë.

Kryetarja, konstatoi se komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur, më 13 prill 2022.

3. Takim në komision me ekspertin e angazhuar nga UN Women, lidhur me përfundimin e Draft ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore.

Të ftuar edhe përfaqësuesit nga: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Barazi Gjinore dhe UN Women;

Kryetarja, lidhur me Draft ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore, tha se prezentë kemi z.Hilmi Jashari, ekspert i angazhuar nga UN Women, Nita Shala, zëvendësministre e Drejtësisë, Edi Gusia, kryeshefe ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore si dhe Vlora Nushin përfaqësuese e UN Women, i falënderoj për prezencën si dhe përkrahjen e vazhdueshme lidhur në punën që po bëhet në draftin e projektligjit.

Vlora Nushi, njoftoi komisionin se këtë proces do ta mbështesë z. Hilmi Jashari. Obligimet dhe përshtetshmërinë e punës së z.Jashari, e ka nda me komisionin, përveç analizës si pjesë e asaj se çka është bërë deri tash dhe të gjeturat të cilat do t'i diskutoni sot. Këtu do të jetë edhe vendosja e një kalendari të ri me të cilin ju pajtoheni, kohëzgjatja është deri në shtator por se në diskutim me ju eksperti ka thënë se kjo mund të kryhet shumë më herët.

Hilmi Jashari, falënderoi komisionin për ftesën për të përcjellë komentet lidhur me një projektligj që konsiderohet të jetë jashtëzakonisht jetik, tha se e ka shqyrtuar draftin dhe të gjitha komentet që kanë arritur prej të gjitha organizatave që kanë marrë pjesë në hartimin e këtij draft ligji. Shqetësimi i tij është tek ato që nuk janë përfshirë në këtë draft. E para, tha se ka të bëjë me zbatimin e standardeve ndërkombëtare, e që në këtë rast i referohet Konventës së Stambollit e që është mekanizëm i Këshillit të Evropës, e dyta ka të bëjë me atë se nuk është bërë dallimi i qartë mes procedurave penale dhe atyre civile. Në këtë pjesë të këtij ligji kjo duhej të trajtohej saktësisht në çështjet e trajtimit nga Gjykata Civile për Parandalimin e Dhunës dhe për të nxjerrë masa ndaj atyre personave që nuk është dhunë në domenin penal, mirëpo, mund të jetë dhunë në domenin e asaj që Konventa e Stambollit e quan përgjegjësi civile. Problemi i tretë është përgjegjësia e autoriteteve të cilat konsiderohen se nuk e kanë zbatuar ligjin, në draftin aktual nuk përmenden dispozitat sanksionuese për autoritetin, kjo pjesë do duhej të trajtohej me një kapitull të veçantë. E katërta është që disa prej segmenteve më të rëndësishme të Konventës së Stambollit nuk janë trajtuar fare, siç është parandalimi, kemi disa çështje që janë të rëndësishme prej trajnimit të profesionistëve, pjesëmarrja e mediave dhe sektorit privat që është trajtuar shkurt, ngritja e ndërgjegjësimit edukimi, sfida e stereotipave, promovimi i fuqizimit të grave dhe programet për ushtruesit e dhunës.

Ai tha se ka një propozim që tejkalon pjesën e këtij ligji e që ka të bëjë me kodifikimin e së drejtës së kësaj fushe që është në fuqi, siç është Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Ligjin për Mbikëqyrje Elektronike dhe Kodin Penal.

Kryetarja, tha se për komisionin është e rëndësishme koha, sepse ka kaluar mjaft kohë prej momentit kur kemi filluar me procesin dhe jemi të interesuar që të kemi një draft përfundimtarë dhe të kompletuar edhe me këto pjese shtesë.

Nita Shala, tha se po mbesim në pritje të një drafti të konsoliduar, Ministria e Drejtësisë i ka dërguar komentet me shkrim, kryesisht janë fokusuar në rolin e Zyrës së Koordinatorit si mekanizmi kryesor, i cili do duhej të ketë përsipër koordinimin e gjithë aktorëve.

Sa i përket raportit të vlerësimit nga ekspertët GREVIO, sa i takon zbatimin të Konventës së Stambollit, tha se është drafti i raportit në gjuhën angleze dhe kanë kërkuar nga Zyra e Këshillit të Evropës që t'na i ofrojnë të përkthyer në gjuhën shqipe, në mënyrë që institucionet tona të kenë mundësi të japin komentet në gjuhën shqipe. Është premtuar që nga data 18 maj do ta dorëzojnë dhe të njëjtin do t'ua shpërndajnë edhe komisionit dhe gjithë aktorëve. Kemi hapësirë vetëm dy javë për ta komentuar, dhe këto janë komentet të cilat do ta ndryshojnë draftin e dokumentit.

Edi Gusia, deklaroi se janë të pajtimit me rekomandimet që i dha eksperti, janë të gatshëm që të mbështesin procesin ashtu si deri më tani, sa i përket kodifikimit, eksperti ka të drejtë, si ABGJ-ja disa herë e kanë ngritur këtë çështje dhe kjo nuk ka të bëjë vetëm me këtë ligj por me ligjet në përgjithësi sepse është vërejtur tek koncept dokumentet që po sillen për ligje dhe në përgjithësi ka tendenca se ligjet kanë kolizion ndër vete dhe dy at tri herë nëpër takime publike e kemi thënë se Ministria e Drejtësisë duhet ta ketë një departament të veçantë që duhet të merret me kodifikimin dhe realisht eviton kolizionin mes ligjeve.

Kryetarja, tha se me sa ka kuptuar, propozohet të bëhet kodifikim i ligjeve të natyrës përafërsisht të njëjtë pra siç u ceken më parë, dhe kjo mund të bëhet pas miratimit të këtij projektligji për të cilin po diskutojmë, apo?

Eliza Hoxha, tha se për deputetët e ri një propozim për kodifikim të së drejtës është iluminim, sidomos edhe për ata që nuk janë të fushës juridike dhe hasin në sfidë edhe gjatë hulumtimeve të çështjeve të caktuara. Sa i përket aspektit të Ligjit për Barazi Gjinore dhe iniciativa që të harmonizohet me Ligjin për Zgjedhjet, aty është kuota 30%, ndërsa Ligji për Barazi Gjinore bën thirrje që në çdo institucion në çdo proces të kemi përfaqësim të barabartë gjinor dhe normal që përdoret, varësisht nga situata njëri ligj apo tjetri, për faktin që nuk është ligj që mbivendoset mbi ligjet e tjera, prandaj, mendoj që kodifikimi në cilëndo fushë që përfshin ligjet e caktuara duhet të bëhet.

Alban Bajrami, tha se shqetësuese është koha e zgjatur, është gjë e mirë që eksperti është zotuar në përsheptim të procesit, janë përfshirë një numër i madh i institucioneve në hartimin e draftit, përfshirë gjykatës të fushës penale dhe civile. Tani me komentet e reja që po jepni është mirë të nguteni në harmonizimin e draftit, organizimin e një punëtorie dhe t'i eliminojmë kundërthëniet mes asaj çka është në draft dhe çka po thuhet këtu, t'i jepet prioritet këtij ligji sepse jemi vonuar dhe leximin e parë në Kuvend ta kemi në këtë sesion.

Ariana Musliu -Shoshi, tha se është dakord me rekomandimet e ekspertit, që të kemi një kodifikim të së drejtës në këtë fushë sepse është më e lehtë edhe për të tjerët që të qasen.

Hilmi Jashari, tha se ideja e kodifikimit ka të bëjë me harmonizimin dhe evitimin e kolizionit dhe ndeshjeve që mund të kenë dispozitat e ndryshme.

Edi Gusia, tha se ky propozim për kodifikim është i dobishëm, por për në një fazë të mëvonshme. Herën e kaluar drafti është adresuar në Ministri të Financave për llogaritje buxhetore, Ministria e Financave nuk e ka bërë një gjë të tillë ende.

Labint Demi, tha se në legjislaturën 5, deputetja Alma Lama ka ngritur një lëndë në Gjykatën Kushtetuese për çështjen e Qeverisë, se a duhet të jetë kuota e përfaqësimit gjinor 50/50, dhe kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese, që e ka kundërshtuar. A kemi mjaftueshëm ligje për t'i kodifikuar apo jemi ende në fazën e krijimit të ligjeve për të arritur pastaj te një kodifikim sepse parimisht nuk kemi ligj në fuqi për Qeverinë që përcakton shumë norma që kanë të bëjnë me Qeverinë.

Hilmi Jashari, tha se si ish- Avokat i Popullit, lidhur me rastin Alma Lama, e ka dërguar në gjykatë padinë duke e përcjellë me masën e sigurisë, që gjykata në atë kohë të anulojë certifikimin e zgjedhjeve sipas kuotës 30%, sepse kam konsideruar se është shkelur Ligji për Barazinë Gjinore dhe për arsye të caktuara ka përparësi zbatimimi në krahasim me Ligjin për Zgjedhjet Përgjithshme.

Drita Millaku, sa i përket Ligjit për Barazi Gjinore, tha se ajo dhe deputetja Tinka, kanë qenë protagoniste në Gjykatën Kushtetuese për ta kërkuar një të drejtë që ju takon. Gjatë diskutimeve, çështja e parë që është hasur si pengese është se sa kushton kostoja buxhetore për ndryshimin e këtyre projektligjeve edhe pse janë të domosdoshme harmonizimet, në qoftë se përfundimisht na vjen një kosto e lartë e që është e papërbalueshme për Qeverinë, çka do mund të bëjmë që t'i harmonizojmë ligjet, të cilat nuk kanë kosto buxhetore.

Hilmi Jashari, tha se në momentin kur miratohet ligji në Kuvend, pavarësisht sa është kostoja, është një e drejtë që është garantuar nga ana e shtetit dhe shteti mban përgjegjësi karshi qytetarit.

Vlora Nushi, tha se sa i përket koston së këtij projektligji do flasin edhe një herë tjetër.

Kryetarja, pyeti se sa kohë i duhet ekspertit që ta sjellë një draft të konsoliduar para komisionit, dhe pastaj të mbahet punëtorja.

Hilmi Jashari, tha se shpreson që brenda një muaji, deri më 20 qershor 2022, mund ta sjellë draftin.

Alban Bajrami, kërkoi që drafti i projektligjit të përfundojë deri me 13 qershor dhe menjëherë të shkohet në punëtori.

Hilmi Jashari, tha se për këtë do ta njoftojë kryetaren brenda dy ditëve se a mund ta përfundojë draftin më 13 qershor.

Kryetarja, tha se për të gjitha do të mbesin në kontakt dhe i falënderoj të gjithë për kontributin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:25.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Duda BALJE,

Kryetare e Komisionit
